



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 5197 Më 24.08.2023
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Procesverbal i Dëgjimeve për Buxhetin e vitit 2024 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 në Shtëpinë e Kulturës, Ratkoc

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2024 dhe KAB-in për vitet 2024-2026, u publikua me datë: 28.07.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

*Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: **14.08.2023** deri me datë: **18.08.2023** nën organizimin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Rahovecit, do të organizohen njëmbëdhjetë (11) dëgjime publike buxhetore.*

*Dëgjimi publik me qytetarët e Ratkocit, Dejnit, Malësisë së Vogël, Vrajakës, Bratotinit dhe Gexhës, për planifikimin e buxhetit për vitin **2024** dhe KAB-in për vitet **2024-2026**.*

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendar i dëgjimeve buxhetore për njëmbëdhjetë (11) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf> më datë: 28.07.2023.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar OJQ-të, Bizneset dhe Grupet e Interesit, Buxhetimi Gjinator ku janë janë të informuar edhe gjinia **femërore**, si dhe Bashkësitë Lokale dhe lagjet urbane përfaqësuesit të shkollave dhe rininë, rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me qytetarët e Ratkocit, Dejnit, Malësisë së Vogël, Vrajakës, Bratotinit dhe Gexhës, u publikua më datë 07.08.2023 në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/08/Njoftim-per-mbajtjen-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2024-Ratkoc.pdf>

Njoftimet, përveç që janë publikuar në ueb-faqe të Komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social *Facebook*, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale *Viber dhe WhatsApp*.

DËGJIMI PUBLIK ME qytetarët e Ratkocit, Dejnit, Malësisë së Vogël, Vrajakës, Bratotinit dhe Gexhës

Dëgjimi buxhetor me qytetarët e Ratkocit, Dejnit, Malësisë së Vogël, Vrajakës, Bratotinit dhe Gexhës, u mbajt më: 15.08.2023, në Objektin e Shtëpisë së Kulturës, në Ratkoc, me fillim në orën **20:00**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga Grupi punues dhe zyrtarë komunalë, ishin: 4

- Femra ishin: 0
- Meshkuj ishin: 4

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 36

- Femra ishin: 0
- Meshkuj ishin: 36

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimin e shpalli të hapur drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, Afrim Limani.

Afrim Limani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar qytetarë të Ratkocit, Dejnit, Malësisë së Vogël, Vrajakës, Bratotinit dhe Gexhës, ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu!

Jemi sot këtu ne dëgjimet buxhetore, për të marrë kërkesat tuaja si qytetarë të Ratkocit, Dejnit, Malësisë së Vogël, Vrajakës, Bratotinit dhe Gexhës, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2024.

Buxheti për vitin 2024 do të jetë: 20,034,785.00 euro, **Paga dhe mëditje** në vlerë prej 10,300,983.00 euro, **Mallra dhe Shërbime** në vlerë prej 2,466,340.00 euro, **Shërbime Komunal** në vlerë prej 370,000.00 euro, **Subvencione dhe Transfere** në vlerë prej 890,000.00 euro, si dhe **Investimet Kapitale** kapin vlerën prej 6,007,462.00 Euro.

Ju lus që kërkesat edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokolluara t'i sillni dhe në Komunë, që më pas të cedohen nëpër drejtoritë përkatëse. Urdhëroni ju të nderuar qytetarë të Ratkocit, Dejnit, Malësisë së Vogël, Vrajakës, Bratotinit dhe Gexhës.

Beqë Shala, kryetar i fshatit Ratkoc: Të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Zgjerimi i kanalizimit në disa pjesë të fshatit,
- Rregullimi i përrenjve - vazhdimi i tyre,
- Ndërtimi i trotuarit prej Ratkocit deri në Dejnë,
- Zgjerimi i ndriçimit publik në disa lagje të fshatit,
- Rrugët fushore,
- Kubëzimi i disa rrugëve në fshat.

Murat Morina, kryetar i fshatit Malësi e Vogël: Të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rregullimi i kanalit të tokave Bujqësore,
- Rregullimi i përroit tek Oda e fshatit e deri te hekurudha,
- Rregullimi i shtratit prej pikës së grumbullimit të qumështit deri te varrezat,
- Rrugët fushore,

- Rregullimi i rrugës te varrezat afër Drinit,
- Trotuaret prej hekurudhës deri tek qendra e fshatit,
- Rrugët e disa lagjeve, si 600 deri 700 metra, afër shkollës te Musa Met,
- Kanali i kullimit të tokave nga Ratkoci deri te fshati Gexhë ka hekurudha,

Nexhmedin Krasniqi, kryetar i fshatit Gexhë: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Shtrimi i 3 rrugëve me kubëza,
- Rregullimi i oborrit të Odës së Fshatit Gexhë,
- Kanali i kullimit te qendra e fshatit deri te hekurudha 200 – 400 metra,
- Kanalizimi në lagjen e Gradishit.

Avni Morina, fshati Vrajakë: Të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rruga e degëzimit Vrajakë-Bratotin-Ratkoc, të riparohet sepse është dëmtuar,
- Rrugët fushore Vrajakë, Bratotin,
- Trotuari te rruga e Arashit te shkolla që lidh dy fshatrat Vrajakë - Bratotin,
- Trotuari në rrugën kryesore prej Ratkocit - Vrajakë dhe Bratotin.

Esat Hoti, fshati Ratkoc: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rruga “Lulzim Hoti” - shtrimi me kubëza,
- Uji i pijes, problem me ujë të pijes gjatë sezonës së verës,
- Ndriçimi publik në rrugën “Lulzim Hoti”,
- Trotuari në rrugën “Lulzim Hoti”.

Bashkim Zena, fshati Malësi e Vogël: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rregullimi i kanalizimit në mes të fshatit, sepse gjatë reshjeve atmosferike, uji depërton nëpër shtëpitë private.

Gani Hoti, fshati Ratkoc: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rrethi i oborrit të Shkollës së Mesme “12 Maji” në Ratkoc, mungesa e sigurisë në shkollë,
- Uji i pijes, problem me ujë të pijes gjatë sezonës së verës,
- Ndriçimi publik afër Shkollës “12 Maji”,
- Ndriçimi publik tek Ambulanca në Ratkoc.

Valmir Bytyqi, fshati Dejnë: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Mirembajtja e ndriqimit publik në Rrugen Arben Bytyqi,
- Rregullimi i rrugëve fushore dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese,
- Ndertimi i urës tek Hekurudha,
- Ndertimi i rrugëve me kubeza betoni për rrugën Arben Bytyqi në gjatësi 200 metra, Rruga tek Automekaniku Muhamet Bytyqi, si dhe rrugët tjera,
- Intervenimet ne kanalizimin e Fshatit për shkak se po shkaktohen vërshime gjate reshjeve atmosferike.

Mustafë Krasniqi, fshati Malësi e Vogël: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rregullimi i përroit nga fshati Gexhë, deri në Radoste.

Bujar Hoti, fshati Ratkoc: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Ndërtimi i kanalizimit në drejtim nga Fshati Dejnë, te hekurudha.

Ali Morina, fshati Ratkoc: Të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rruga te përroi i biçecve, pengesa nga vërshimet.

Afrim Limani: Faleminderit qytetarë të Ratkocit, Dejnit, Malësisë së Vogël, Vrajakës, Bratotinit dhe Gexhës që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Dëgjimi publik përfundoi në orën: 20:40

Rahovec: 15.08.2023

Ekrem Bytyçi
Kryesues i Grupit Punues